

SHTOJCA NR. 1

NJOFTIM PËR PËRZGJEDHJEN E PËRFAQËSUESVE TË INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË, NË KËSHILLIN KONSULTATIV PËR NDËRMARRJET MIKRO, TË VOGLA DHE TË MESME

Në zbatim të ligjit nr. 43/2022 “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme”, të vendimit nr. 541, datë 29.7.2022 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e përzgjedhjes të anëtarëve, si dhe për organizimin, funksionimin dhe kompetencat e Këshillit Konsultativ për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme” dhe urdhrin nr. 710, datë 1.12.2022, të MAS “Për njoftimin e fillimit të procedurave të përzgjedhjes së përfaqësuesve të institucioneve të arsimit të lartë (IAL), në Këshillin Konsultativ për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, mënyrën e vlerësimit të kandidatëve dhe afatin e dorëzimit të dokumentacionit”, Ministria e Arsimit dhe Sportit shpall njoftimin për fillimin e procedurave të përzgjedhjes së përfaqësuesve të IAL-ve në Këshillin Konsultativ për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (Këshilli Konsultativ për NMVM-të), si më poshtë:

Nr.	Institucioni i arsimit të lartë	Numri i anëtarëve përfaqësues të IAL-ve
1.	Institucioni publik i arsimit të lartë	• 1 (një) përfaqësues
2	Institucioni jopublik i arsimit të lartë	• 1 (një) përfaqësues

1. Përshkrim i përgjithshëm

Këshilli Konsultativ për NMVM-të është organ këshillimor dhe transparence, që ngrihet pranë ministrisë përgjegjëse për çështjet e ekonomisë, me përfaqësues nga organizatat e biznesit dhe institucionet shtetërore.

Këshilli kryesohet nga ministri përgjegjës për ekonominë dhe përbëhet nga 11 anëtarë me eksperiencë pune jo më pak se 10 vjet në fushën e ekonomisë dhe në mbështetjen e zhvillimit të biznesit si më poshtë:

- a) 1 përfaqësues nga ministria përgjegjëse për financat dhe ekonominë;
- b) 1 përfaqësues nga ministria përgjegjëse për mbrojtjen e sipërmarrjes;
- c) 1 përfaqësues nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve;
- ç) 1 përfaqësues nga Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë;
- d) 3 përfaqësues të sipërmarrjes dhe biznesit, të përzgjedhur nga organizatat dhe dhomat më të përfaqësuara të tregtisë dhe biznesit;
- dh) 1 përfaqësues nga Shoqata e Bankave;
- e) 2 përfaqësues nga institucionet e arsimit të lartë, nga të cilët një përfaqësues nga institucionet publike të arsimit të lartë dhe një përfaqësues nga institucionet jopublike të arsimit të lartë.
- ë) 1 përfaqësues nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, të propozuar nga Shoqata e Bashkive të Shqipërisë.

Anëtarët e Këshillit emërohen me urdhër të ministrit përgjegjës për ekonominë pas propozimit nga institucionet apo organizatat e parashikuara, për një mandat 3-vjeçar me të drejtë riemërimi një herë.

2. Kompetencat e Këshillit Konsultativ për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme

Këshilli Konsultativ për NMVM-të ushtron kompetencat e mëposhtme:

- diskuton çështjet që lidhen me mbështetjen dhe zhvillimin e biznesit;
- jep mendime dhe këshilla për mbështetjen dhe zhvillimin e biznesit;
- këshillon për mënyrën e hartimit të skemave mbështetëse për biznesin sipas parashikimeve të këtij ligji dhe Strategjisë për Zhvillimin e Biznesit dhe Investimeve.

3. Kërkesat e pranimit

- a) të kenë integritet të lartë moral dhe profesional;
- b) të pranojnë në mënyrë vullnetare të jenë anëtarë të Këshillit Konsultativ;
- c) të kenë aftësi të mira komunikimi dhe mund të kontribuojnë në propozimin për përmirësimin e klimës së biznesit;
- d) të jenë të pavarur dhe të paanshëm në ushtrimin e funksioneve të tyre si anëtarë të Këshillit Konsultativ.

4. Lista e dokumentacionit, vendi dhe afati i dorëzimit

- Kërkesë për aplikim ku të jetë specifikuar IAL që kandidati do të përfaqësojë;
- Jetëshkrim i plotësuar në gjuhën shqipe (CV- Curriculum Vitae);
- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën "Bachelor"). Për diplomat dhe certifikatat e lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara, jashtë Republikës së Shqipërisë, të përcillet Vërtetimi i Njohjes dhe Njehsimit të Diplomës/Certifikatës, të lëshuara nga strukturat përgjegjëse përkatëse;
- Fotokopje të librezës së punës;
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- Dëshmi e njohjes së gjuhës së huaj;
- Vërtetim që nuk ka masë disiplinore në fuqi për largim nga detyra;
- Formular i vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore;
- Vetëdeklarim për verifikimin e vërtetësisë së dokumenteve të paraqitura nga kandidati, sipas shtojcës nr. 1/1.

5. Paraqitja e dokumenteve të cituara më sipër, do të jetë deri në datën 15.12.2022 në një nga këto mënyra:

- a) Me postë zyrtare në adresë të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.
- b) Dorëzimi dorazi në ambientet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Dokumentacioni administrohet nga Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, e cila vë në dispozicion të Komisionit "Ad hoc" të ngritur me urdhër Ministri, dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët.

6. Mënyra dhe koha kur do të shpallet lista e kandidatëve të përzgjedhur

- Përzgjedhja e kandidatëve për përfaqësues të institucioneve të arsimit të lartë (IAL), në Këshillin Konsultativ për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, kryhet nga një komision “*Ad-hoc*” i ngritur me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin, i cili shqyrton dokumentacionin e paraqitur brenda 10 ditëve pune, nga data e përfundimit të afatit të aplikimit dhe harton listën e kandidatëve të kualifikuar, që plotësojnë kriteret ligjore.
- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Ministria e Arsimit dhe Sportit do të shpallë kandidatët e përzgjedhur në faqen e saj zyrtare, www.arsimi.gov.al.

SHTOJCA NR. 1/1

Vetëdeklarim për verifikimin e vërtetësisë së dokumenteve të paraqitura nga kandidati

Unë, i nënshkruari _____, kandidat në procesin e konkurrimit për përfaqësues të institucioneve të arsimit të lartë (IAL), në Këshillin Konsultativ për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, autorizoj Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, të verifikojë në çdo kohë vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura nga ana ime.

Datë _____

Nënshkrimi _____